



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 31.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **30.05.2022** të parashtruar nga OE-ik "FLORIM TALLA B.I.-NTSH BENI REISEN" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve"**, me Nr. të Prok: **616-22-3621-2-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 054 221** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE-ik "FLORIM TALLA B.I.-NTSH BENI REISEN" të dt. 30.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve"**, me Nr. të Prok: : **616-22-3621-2-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 054 221**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK –së, të datës 26.05.2022.

1. Refuzohet kërkesat për Rishqyrtim e datës 30.05.2022 kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 26.05.2022
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj sipas Njoftimit mbi vendimin e AK per aktivitetin e prokurimit per tenderin **"Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve"**, me Nr. të Prok: **616-22-3621-2-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 054 221**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE-ik "FLORIM TALLA B.I.-NTSH BENI REISEN" me datë 30.05.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **"Transporti i nxënësve dhe arsimtarëve"**, me Nr. të Prok: **616-22-3621-2-2-1 dhe numër te brendshëm 616 22 054 241**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.05.2022, ka bere Njoftimin mbi Vendimin e AK per **"Transportin e nxënësve dhe arsimtarëve"**.

Ne njoftimin mbi vendimin e AK eshte dhene qarte se kush propozohet per kontrate dhe jane sqaruar arsyet e eliminimit per Operatoret Ekonomik te papergjegjshem.

AK ka respektuar dhe ka bere vleresimin gjithnje duke e respektuar LPP respektivisht parimet e Pergjithshme te LPP Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe nenin 7 Barazia ne trajtim – jo diskriminimi.

Ne Dosjen e Tenderit te FDT pika 13.1 dhe 13.2 eshte kerkuar se: *Shuma e Sigurimit të Tenderit është: 1000€ për secilin loto për 90 dite*

Sigurimi i tenderit duhet te dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit te tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërblej me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale te sigurimit te tenderit shpije ne zbatimin e nenit 99.2 te LPP-se

Ne LPP dhe ne RRUOPP ne nenin 29.7 shkruan: Afati I fundit për dorëzim te sigurimit te tenderit do te jete I njëjtë si ai për dorëzim te tenderëve. Sigurimet e tenderëve te pranuarra pas afatit për dorëzimin e tenderit do te refuzohet dhe kështu do te rezultojë ne refuzimin e tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Departamenti i Prokurimit

